



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:
Ministria e Punëve të Brendshme

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit themelor (637)

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht, dhe nëse aktivitetet dhe transaksionet janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- Ministria disponon me 513 objekte ndërtimore, prej të cilave për 45 objekte posedon flet pronësie si dokument për pronësi, ndërsa për 53 objekte ndërtimore vazhdon procedura për legalizimin, e filluar në vitin 2013;
- Regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve nuk është kryer në pajtim me Rregulloren për kontabilitet të buxheteve dhe shfrytëzuesit buxhetor;
- Parregullsi gjatë zbatimit të prokurimeve publike.

Mendimi i dhënë/përfundim*:



Me revizionin e kryer për vitin 2020, shprehëm mendim me rezervë për të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Rekomandimet kyçe:

- Vazhdimi i aktiviteteve për marrjen e flet pronësive për të gjitha asetet e përhershme të cilat janë pronë ose të cilat i shfrytëzon ministria,
- Zbatimi i regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve në pajtim me rregullativën ligjore.

Dobësitë kyçe të sistemit:

/

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nga personi i autorizuar i Ministrisë janë marrë vërejtje të draft-raportit të revizorit të autorizuar shtetëror.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Vërejtjet janë rishikuar dhe është konstatuar se tri vërejtje paraqesin njoftim për aktivitetet e ndërmarra për tejkalimin e gjendjes së konstatuar në draft-raportin, një vërejtje pranohet dhe një vërejtje nuk pranohet.

* pozitive, me rezervë, të pavolitshëm, të përmbajtur